SONY

4-528-304-11(1) (AL)

Sistemi personal audio

AL Udhëzimet e përdorimit

* 4 5 2 8 3 0 4 1 1 * (1)

©2014 Sony Corporation

CMT-X5CD/CMT-X5CDB

http://www.sony.net/

Made for iPod iPhone

Download on the App Store

PARALAJMËRIM

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj.
Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtur (për shembull, qirinjtë e ndezur).

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëngje, si p.sh. vazo.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, futeni njësinë në priza elektrike që mund të arrihen lehtë. Nëse vini re ndonjë anomali në njësi, shkëputni menjëherë spinën kryesore nga priza e rrymës alternative.

Mos e instaloni pajisjen në hapësira të kufizuara si p.sh. në rafte librash apo në mobilie në mur.

Mos i ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluara ndaj nxehtësisë së tepruar si p.sh. drita e diellit dhe zjarri.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është futur në prizë, edhe nëse vetë njësia është e fikur.

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve të përcaktuara në Direktivën EMC për përdorimin e një kabllo lidhëse më të shkurtër se 3 metra.

Kjo pllakëz metalike ndodhet në pjesën e poshtme të pasme.

KUJDES

Përdorimi i mjeteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun ndaj syve.

CLASS 1 LASER PRODUCT
LUOKAN 1 LASERLAITE
KLASS 1 LASERAPPARAT

Kjo pajisje klasifikohet si produkt LAZER I Kuqsht 1. Kjo shenjë ndodhet në pjesën e jashtme poshtë.

KUJDES

Rrezik shpërthimi nëse bateria zëvendësohet në mënyrë të pasaktë. Zëvendësojeni vetëm me lloj ti njëjtë ose ekuivalent.

Për klientët në Evropë

Njoftim për klientët: informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen direktivat e BE-së.
Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtojuni adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit ose të garancisë.

Përmes kësaj, Sony Corp., deklaron se kjo pajisje është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/EC. Për detaje, vizitoni URL-në e mëposhtme:
http://www.compliance.sony.de/

Për klientët në Evropë dhe Australi

Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (vlen për Bashkimin Evropian dhe shtetet të tjera evropiane me sisteme grumbullimi të diferencuar)
Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Vetëm për Evropën

Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme grumbullimi të diferencuar)
Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria që jepet me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.
Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb.
Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzojeni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.
Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzojeni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.
Për të dhëna më të hollësishme mbi riciklimin e këtij produkti ose të baterisë, kontaktoni me bashkinë, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Njoftim për licencën dhe markat tregtare

- Windows Media është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.
- Ky produkt është i mbrojtur nga disa të drejta të pronësisë intelektuale të Microsoft Corporation. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencë nga Microsoft ose një filial i autorizuar i Microsoft.
- Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- "WALKMAN" dhe simboli "WALKMAN" janë marka të regjistruara tregtare të Sony Corporation.
- © 2013 CSR plc dhe kompanitë e grupit të vet. Shenja aptX® dhe logoja aptX janë marka tregtare të CSR plc ose një prej kompanive të grupit të vet dhe mund të jetë e regjistruar në një ose më shumë juridiksione.
- Logot dhe marka e fjalës BLUETOOTH® janë marka tregtare të regjistruara që zotërohen nga BLUETOOTH SIG, Inc. dhe çdo përdorim i tyre nga Sony Corporation bëhet me licencë.
- Marka N është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e NFC Forum, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtetet të tjera.
- Android dhe Google Play janë marka tregtare e Google Inc.
- Emrat e sistemeve dhe produkteve të treguara në këtë manual janë në përgjithësi marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të prodhuesit. Shenjat ™ dhe ® janë hequr në këtë manual.
- Apple, logoja Apple, iPad, iPhone, iPod, iPod classic, iPod nano dhe iPod touch janë marka tregtare të Apple Inc., të regjistruara në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera. App Store është markë shërbimi e Apple Inc.
- "Made for iPod" dhe "Made for iPhone" nënkuptojnë se një aksesor elektronik është projektuar për t'u lidhur në mënyrë specifike përkatësisht me një iPod dhe iPhone dhe është certifikuar nga zhvilluesi i tij se përputhet me standardet e performancës së Apple. Apple nuk është përgjegjëse për funksionimin e kësaj pajisjeje ose pajtueshmërinë e saj me standardet rregullatore dhe të sigurisë. Ju lutemi vini re se përdorimi i këtij aksesori me iPod ose iPhone mund të ndikojë në performancën e lidhjes me valë.
- "Xperia" dhe "Xperia Tablet" janë marka tregtare të Sony Mobile Communications AB.

Përpara përdorimit të këtij sistemi

Keqfunksionimet që ndodhin gjatë përdorimit normal të sistemit do të riparohen nga Sony në përputhje me kushtet e përcaktuara në garancinë e kufizuar për këtë sistem. Megjithatë, Sony nuk do të jetë përgjegjës për asnjë pasojë që lind nga dështimi i luajtjes ose keqfunksionimi i sistemit.

Disqet muzikore të koduara me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit

Ky produkt është krijuar për të luajtur disqe që ndjekin standardin e kompakt diskut (CD). Kohët e fundit, disa kompani regjistrimesh tregtojnë disqe të ndryshme muzikore të koduara me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Ju lutemi vini re se mes këtyre disqeve ka të tilla që nuk janë konform me standardin CD, dhe mund të mos luhen dot nga ky produkt.

Shënim për DualDisc-et

Një DualDisc është një produkt disk me dy anë i cili përmban material të regjistruar DVD në njërën anë dhe material dixhital audio në anën tjetër. Megjithatë, duke qenë se ana me material audio nuk është konform me standardin e kompakt-diskut (CD), nuk garantohet riprodhimi në këtë produkt.

Njoftim ndaj licencës dhe markat tregtare

- Windows Media është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.
- Ky produkt është i mbrojtur nga disa të drejta të pronësisë intelektuale të Microsoft Corporation. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencë nga Microsoft ose një filial i autorizuar i Microsoft.
- Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- "WALKMAN" dhe simboli "WALKMAN" janë marka të regjistruara tregtare të Sony Corporation.
- © 2013 CSR plc dhe kompanitë e grupit të vet. Shenja aptX® dhe logoja aptX janë marka tregtare të CSR plc ose një prej kompanive të grupit të vet dhe mund të jetë e regjistruar në një ose më shumë juridiksione.
- Logot dhe marka e fjalës BLUETOOTH® janë marka tregtare të regjistruara që zotërohen nga BLUETOOTH SIG, Inc. dhe çdo përdorim i tyre nga Sony Corporation bëhet me licencë.
- Marka N është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e NFC Forum, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtetet të tjera.
- Android dhe Google Play janë marka tregtare e Google Inc.
- Emrat e sistemeve dhe produkteve të treguara në këtë manual janë në përgjithësi marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të prodhuesit. Shenjat ™ dhe ® janë hequr në këtë manual.
- Apple, logoja Apple, iPad, iPhone, iPod, iPod classic, iPod nano dhe iPod touch janë marka tregtare të Apple Inc., të regjistruara në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera. App Store është markë shërbimi e Apple Inc.
- "Made for iPod" dhe "Made for iPhone" nënkuptojnë se një aksesor elektronik është projektuar për t'u lidhur në mënyrë specifike përkatësisht me një iPod dhe iPhone dhe është certifikuar nga zhvilluesi i tij se përputhet me standardet e performancës së Apple. Apple nuk është përgjegjëse për funksionimin e kësaj pajisjeje ose pajtueshmërinë e saj me standardet rregullatore dhe të sigurisë. Ju lutemi vini re se përdorimi i këtij aksesori me iPod ose iPhone mund të ndikojë në performancën e lidhjes me valë.
- "Xperia" dhe "Xperia Tablet" janë marka tregtare të Sony Mobile Communications AB.

Marrja e stacionit të radios DAB/DAB+ (vetëm CMT-X5CDB)

Kur e ndizni sistemin për herë të parë pasi e keni blerë, skanimi automatik DAB fillon automatikisht dhe krijon një listë të shërbimeve të disponueshme. Gjatë skanimit automatik DAB shfaqet "********". Mos shtypni asnjë buton në këtë pozicion me telekomandë gjatë skanimit automatik DAB. Skanimi ndërpritet dhe lista e shërbimit mund të mos krijohet si duhet. Për të ekzekutuar manualisht skanimin automatik DAB, kryeni procedurën "Ekzekutimi i skanimit automatik DAB manualisht". Nëse keni lëvizur në një zonë tjetër, kryeni skanimin automatik DAB manualisht dhe regjistroni sérish përmbajtjet e transmetimeve.

Fillimi

Vendndodhja e kontrolleve

Shënim
Ky manual shpjegon kryesisht veprimet me telekomandën, por të njëjtat veprime mund të kryhen duke përdorur butonat në njësi që kanë emra të njëjtë ose të ngjashëm.

Telekomanda



Njësia (përpara/lart)



Kur përdorni telekomandën për herë të parë
Bateria është e instaluar në fabrikë në telekomandë. Përpara se të përdorni telekomandën për herë të parë, hiqni fletën izoluese të ngjitur te mbajtësi i baterisë.
Për detaje, shihni "Ndërrimi i baterisë".

Njësia (prapa)



A Porta (USB)
Lidhni një pajisje USB.

Shënim
- Nu mund të përdorni iPhone/iPod me këtë sistem vetëm përmes Bluetooth ose lidhjes.

B Foleja AUDIO IN (hyrje e jashtme)
Lidhni pajisjen e jashtme opsionale me një kabllo të lidhjes audio (nuk është e përfshirë).

C Hyrja ~ AC IN (220-240V AC)
Lidhni kordonin e rrymës (jepet) në një prizë muri.

D FM ANTENNA (vetëm për CMT-X5CD) DAB/FM ANTENNA (vetëm për CMT-X5CDB)
Lidhni antenën FM ose DAB/FM.
* Ilustrimi i mësipërm është për CMT-X5CD.

Shënim
- Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali dhe më pas vendosni antenat në një sipërfaqe të qëndrueshme (dritare, mur etj.).
- Siguroni fundin e antenës përçjellëse FM me shirit ngjitës.

Vendosja e orës

1 Shtypni I/⏻ 6 për të ndezur sistemin.
2 Shtypni TIMER 13.
Nëse shfaqet "PLAY SET", shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "CLOCK", më pas shtypni ⊕ 14.
3 Shtypni ♦/♦ 15 për të vendosur orën, më pas shtypni ⊕ 14.
4 Shtypni ♦/♦ 15 për të vendosur minutat, më pas shtypni ⊕ 14.

Shënim
- Cilësimet e orës rivendosen kur shkëputni kordonin e rrymës ose nëse ndodh shkëputje e energjisë elektrike.

Përr shfaqur orën kur sistemi është i fikur

Shtypni DISPLAY 20 në mënyrë të përsëritur për të shfaqur orën. Ora shfaqet për rreth 8 sekonda. Nëse sistemi është në modalitetin e gatishmërisë së BLUETOOTH, ora nuk shfaqet kur shtypni DISPLAY 20.

Dëgjimi i një CD-je

Luajtja e një disku CD-DA/MP3

1 Shtypni FUNCTION 1 për të zgjedhur "CD".
2 Futni një CD në folenë e diskut 9 në pjesën e sipërme të njësisë.
Ngarkoni një CD me anën e etiketës (anën e printuar) drejt vetes.



Riprodhohet automatikisht. Nëse e ndryshoni funksionin në "CD", nga një funksion tjetër kur është futur një CD në fole, shtypni ▶II 2 pasi të jetë zhdukur "READING" nga dritarja e ekranit 7.
Butoni i telekomandës ose i njësisë ju mundëson të përshpejtoni përpara / përshpejtoni prapa, të zgjidhni një pjesë, skedar ose një dosje (për disk MP3), etj.

Për të nxjerr CD-në
Shtypni ⏏ (nxjerrja) 8 në njësi.

Shënim
- Disqet 8 cm nuk mund të përdoren në këtë sistem.
- Mos ngarkoni CD me forma jostandarde (p.sh. në zemre, yll). Kjo mund të shkaktojë dëmtime të paripareushme në sistem.
- Mos përdorni CD me shirita, ngjitëse apo ngjitje mbi to duke qenë se kjo mund të shkaktojë keqfunksionim.
- Kur hiqni një CD, mos prekni sipërfaqen e diskut.

Për të ndryshuar modalitetin e luajtjes

Modaliteti i luajtjes ju mundëson të riprodhoni të njëjtën muzikë në mënyrë të përsëritur ose të luani me përzierje.

Modaliteti i luajtjes



1 Shtypni ■ 17 për të ndaluar riprodhimin.
Nëse zgjidhni "REPEAT" në hapin 4, nuk ju duhet ta ndaloni riprodhimin.
2 Shtypni MENU 19.
3 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "CD MENU", më pas shtypni ⊕ 14.
4 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "PLAYMODE" ose "REPEAT", më pas shtypni ⊕ 14.
5 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur modalitetin e luajtjes, më pas shtypni ⊕ 14.
Ju mund të zgjidhni modalitetet e mëposhtme të luajtjes.

PLAYMODE

Modaliteti i luajtjes	Efekti
NORMAL	Luan një pjesë ose skedar.
FOLDER*	Luan të gjitha pjesët në dosjen e zgjedhur. "FLDR" ndizet në dritaren e ekranit 7.
SHUFFLE	Luan të gjitha pjesët ose skedarët në rend të rastësishëm. "SHUF" ndizet në dritaren e ekranit 7.
FLDR.SHUF*	Luan të gjitha pjesët ose skedarët në dosjen e zgjedhur në rend të rastësishëm. "FLDR. SHUF" ndizet në dritaren e ekranit 7.
PROGRAM	Luan pjesët ose skedarët e programuar. Ndizet "PGM" në dritaren e ekranit 7. Për detaje, shikoni "Krijimi i programit individual (Luajtja e programit)".

* Ky modalitet luajtjeje aplikohet vetëm për luajtjen e një disku MP3.

REPEAT

Modaliteti i luajtjes	Efekti
ALL (Përsëritë të gjitha pjesët)	Sistemi luan të gjitha pjesët në një disk ose dosje në mënyrë të përsëritur. "" ndizet në dritaren e ekranit 7.
ONE (Luan me përsëritje mënyrë të përsëritur. "1" ndizet një pjesë)	Sistemi luan pjesën e zgjedhur në dritaren e ekranit 7.
OFF	Anulon përsëritjen e riprodhimit.

Shënim për luajtjen e disqeve MP3
- Mos ruani dosje ose skedarë të panevojshëm në një disk që ka skedarë MP3.
- Dosjet që nuk kanë skedarë MP3 nuk njihen në sistem.
- Sistemi mund të luajë vetëm skedarë MP3 që kanë një prapashtesë skedari ".mp3".
Edhe kur emri i skedarit ka prapashtesën ".mp3", nëse nuk është një skedar audio MP3, luajtja e këtij skedari mund të gjenerojë një zhurmë të lartë që mund të shkaktojë dëmtim të sistemit.
- Numri maksimal i dosjeve dhe skedarëve MP3 të përputhshëm me këtë sistem është:
—999* dosje (duke përfshirë dosjen rrënjë)
—999 skedarë
—250 skedarë në një dosje të vetme
—8 nivele dosjesh (në strukturë peme skedarësh)
* Kjo përfshin dosjet që nuk kanë skedarë audio që mund të luhen dhe që kanë dosje boshe. Numri i dosjeve që sistemi mund të njohë mund të jetë më i vogël se numri aktual i dosjeve, në varësi të strukturës së dosjeve.
- Sistemi nuk i mbështet domosdoshmërisht të gjitha funksionet e dhëna në pajisjen e lidhur USB.
- Dosjet që nuk kanë skedarë audio nuk njihen.
- Formatet audio që mund të dëgjoni me këtë sistem janë si më poshtë:
—MP3: prapashtesa ".mp3"
—WMA*: prapashtesa ".wma"
—AAC*: prapashtesa e skedarit ".m4a", ".mp4" ose ".3gp"
Vini re se edhe kur emri i skedarit ka një prapashtesë të saktë, nëse vetë skedari është i ndryshëm, sistemi mund të prodhojë zhurmë ose mund të keqfunksionojë.
* Skedarët me mbrojtje të të drejtave të autorit DRM (Digital Right Management) ose skedarët e shkarkuar nga një dyqan muzikor online nuk mund të luhen në këtë sistem. Nëse provoni të luani një nga këto skedarë, sistemi luan skedarin të pambrojtur audio të radhës.

Dëgjimi i muzikës me komponentët opsionalë audio

Riprodhimi i muzikës me komponentët opsionalë audio

Ju mund të luani njësë me komponentë opsionalë audio të lidhur me njësinë.

Shënim
- Përpara kësaj, shtypni VOL – 4 për të ulur volumin.

1 Shtypni FUNCTION 1 për të zgjedhur "AUDIO IN".
2 Lidhni kordonin e tij audio me folenë AUDIO IN B në pjesën e pasme të njësisë dhe terminalin e daljes të njësisë opsionale të jashtme.
3 Nisni riprodhimin e komponentit të lidhur dhe rregulloni volumin.
Rregulloni volumin në komponentin e lidhur gjatë riprodhimit.
4 Shtypni VOL +/– 4 në telekomandë për të rregulluar volumin.

Shënim
- Sistemi mund të kalojë automatikisht në modalitet gatishmërie nëse niveli i volumit të komponentit të lidhur është tepër i ulët. Për detaje, shikoni "Vendosja e funksionit të gatishmërisë automatike".

Dëgjimi i muzikës nëpërmjet një lidhjeje BLUETOOTH

Çiftimi i sistemit me një pajisje BLUETOOTH dhe dëgjimi i muzikës.

Ju mund të dëgjoni muzikë nga pajisja BLUETOOTH me lidhje me valë.
Para përdorimit të funksionit BLUETOOTH, kryeni çiftimin për të regjistruar pajisjen tuaj BLUETOOTH.

Shënim
- Vendoseni pajisjen BLUETOOTH që do të lidhet brenda një metri nga sistemi.
- Nëse pajisja juaj BLUETOOTH është e përputhshme me prekje (NFC), kapërcejeni procedurën e mëposhtme. Shihni "Dëgjimi i muzikës me veprimin me një prekje (NFC)".

1 Shtypni FUNCTION 1 për të zgjedhur "BT AUDIO".
2 Shtypni MENU 19.
3 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "BT MENU", më pas zgjidhni ⊕ 14.
4 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "PAIRING", më pas shtypni ⊕ 14.
5 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "OK" më pas shtypni ⊕ 14.
Kur në dritaren e ekranit fillon të pulsojë "PAIRING" 7, sistemi kalon në modalitetin e çiftimit.
6 Kërkoni për këtë sistem me pajisjen BLUETOOTH.
Një listë e pajisjeve të gjetura mund të shfaqet në ekranin e pajisjes BLUETOOTH.
7 Zgjidhi [SONY:CMT-X5CD] ose [SONY:CMT-X5CDB] (këtë sistem).
Nëse kërkohet që të futni një kod kalimi në pajisjen BLUETOOTH, futni "0000".
Nëse ky sistem nuk shfaqet në ekranin e pajisjes, vazhdoni nga hapi 1 sërish.
Kur kryhet çiftimi, ekrani ndryshon në emrin e pajisjes së lidhur BLUETOOTH nga "PAIRING" dhe treguesi BLUETOOTH ndizet.
8 Shtypni ▶II 2.
Fillon riprodhimi.
Në varësi të pajisjes BLUETOOTH, mund të duhet të shtypni ▶II 2 sërish. Gjithashtu, mund të duhet të hapni një lexues muzikor në pajisjen BLUETOOTH.
9 Shtypni VOL +/– 4 për të rregulluar volumin.
Nëse volumi nuk ndryshohet dot në sistem, rregullojeni le pajisja juaj BLUETOOTH.
Përdorimi si p.sh. i përshpejtimit përpara / përshpejtimit prapa, zgjedhjes së muzikës dhe zgjedhjes së një dosjeje, mund të kryhet me telekomandë ose me butonat e njësisë.

Kësh illë
- Mund të kryeni një veprim çiftimi ose të përpiqeni të bëni një lidhje BLUETOOTH me një pajisje tjetër BLUETOOTH ndërkohë që po krijohet lidhja BLUETOOTH me një pajisje BLUETOOTH. Lidhja BLUETOOTH aktualisht e vendosur do të anulohet kur të krijohet me sukses lidhja BLUETOOTH me një pajisje tjetër.

Shënim
- Veprimet e përshkruara më lart mund të mos jenë të disponueshme për disa pajisje të caktuara BLUETOOTH. Përveç kësaj, veprimet reale mund të ndryshojnë në varësi të pajisjes BLUETOOTH të lidhur.
- Pasi të kryhet veprimi i çiftimit, ai nuk ka nevojë të kryhet sérish. Ne rastet vijuese, sidoqoftë, veprimi i çiftimit duhet të kryhet sérish:
—Informacioni i çiftimit u fshi kur pajisja BLUETOOTH u riparua.
—Ju përpiqeni ta ciftoni sistemin me më shumë se 10 pajisje BLUETOOTH.
Ky sistem mund të ciftohet me 9 pajisje BLUETOOTH. Nëse çiftoni një pajisje tjetër BLUETOOTH pas kryerjes së çiftimit me 9 pajisjet, informacioni i çiftimit të pajisjes që u lidh me sistemin u mbishkrua fillimisht me atë në pajisjen e re.
—Është fshirë informacioni i regjistrimit të çiftimit së këtij sistemi nga pajisja e lidhur.
—Nëse e ndizni sistemin ose fshini historikun e çiftimit me sistemin, i gjithë informacioni i çiftimit do të fshihet.
- Tingulli i këtij sistemi nuk mund të dëgjohet te një altoparlant BLUETOOTH.
- Kodi mund të quhet "Passcode", "PIN code", "PIN number" ose "Password", etj.

Për të kontrolluar adresën e një pajisjeje BLUETOOTH të lidhur

Shtypni DISPLAY 20, ndërkohë që emri i pajisjes BLUETOOTH të caktuar në pajisjen BLUETOOTH të lidhur shfaqet në dritaren e ekranit 7. Adresa e pajisjes BLUETOOTH shfaqet në dy vija në ekranin e sistemit 7 për 8 sekonda.

Për të anuluar lidhjen me një pajisje BLUETOOTH

Shkëputni lidhjen BLUETOOTH në pajisjen BLUETOOTH. "BT AUDIO" shfaqet në dritaren e ekranit 7.

Për të spastruar informacionin e regjistrimit të çiftimit

1 Zgjidhni "DEL LINK" das hapit 3 te "Çiftimi i sistemit me një pajisje BLUETOOTH dhe dëgjimi i muzikës", më pas shtypni ⊕ 14.
2 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "OK", më pas shtypni ⊕ 14.
"COMPLETE" shfaqet në dritaren e ekranit 7 dhe i gjithë informacioni i çiftimit fshihet.

Shënim
- Nëse i keni spastruar informacionet e çiftimit, nuk mund të kryeni një lidhje me BLUETOOTH nëse nuk kryeni përsëri çiftimin.

Dëgjimi i muzikës nëpërmjet një pajisjeje të regjistruar

Pas hapit 1 te "Çiftimi i sistemit me një pajisje BLUETOOTH dhe dëgjimi i muzikës", përdorni pajisjen BLUETOOTH për t'u lidhur me sistemin, më pas shtypni ▶II 2 te njësia për të filluar riprodhimin.

Dëgjimi i muzikës me veprimin me një prekje (NFC)

NFC është një teknologji për komunikim me valë me rreze të shkurtër mes pajisjeve të ndryshme, siç janë celularët dhe etiketat IC.
Thjesht prekni telefonin tuaj smartphone/tabletën me sistemin. Sistemi aktivizohet automatikisht dhe do të kryhet çiftimi dhe lidhja BLUETOOTH.
Përpara kësaj, aktivizoni cilësimet e NFC.

1 Prekni telefonin tuaj smartphone/tabletën me shenjën N 10 në njësi.
Prekni telefonin smartphone/tabletë në njësi dhe nuani kontaktin deri sa telefoni smartphone/tableta të dridhet.
Referojuni udhëzuesit të përdoruesit të telefonit për pjesën e telefonit smartphone/tabletës që përdoret si kontakt me prekje.
2 Pasi të kryeni lidhjen, shtypni ▶II 2.
Për të shkëputur lidhjen e vendosur, prekni telefonin smartphone/tabletën me shenjën N 10 në njësi.

- Nuk mund të garantohet pajtueshmëria me të gjithë softuerët kodues/shkrues MP3 të njësisë CD-R/RW dhe njetet regjistruese. Disqet MP3 që nuk janë të pajtueshëm mund të prodhojnë zhurmë ose audio të ndërpreré ose mund të mos luhen fare.

Krijimi i programit personal (Luajtja e programit)

Luan pjesën ose skedarin e programuar në CD.

1 Zgjidhni "PROGRAM" në hapin e 5 te "Për të ndryshuar modalitetin e luajtjes", më pas shtypni ⊕ 14.
2 Kur përdorni një disk MP3, shtypni 🗀 +/– 15 për të zgjedhur dosjen që përmban pjesët ose skedarët që dëshironi të programoni.
Nëse dëshironi të luani të gjitha pjesët ose skedarët në dosje, shtypni ⊕ 14.
3 Shtypni ⏮/▶▶I 3 për të zgjedhur një pjesë apo skedar të dëshiruar, më pas zgjidhni ⊕ 14.

Numri i pjesës ose skedarit të zgjedhur | **Koha totale e luajtjes së pjesës ose skedarit të zgjedhur**

Përsëritni hapat e mësipërm për të programuar më shumë pjesë ose skedarë.
4 Shtypni ▶II 2.
Programi luaj për pjesët ose skedarët do të fillojë riprodhimin.

Për të anuluar luajtjen e programit
Te hapi 1, zgjidhni "NORMAL" për "PROGRAM", më pas shtypni ⊕ 14.

Për të fshirë një pjesë ose skedar të programuar
Shtypni CLEAR 16 ndërsa luajtësi është i ndaluar. Sa herë që shtypni butonin, do të fshihet pjesa e fundit e programuar:
Kur të fshihen të gjitha pjesët ose skedarët e programuar, shfaqet, "NO STEP".

Kësh illë
- Mund të programohen deri në 25 pjesë ose skedarë. Nëse provoni të programoni më shumë se 25 pjesë ose skedarë, do të shfaqet "FULL". Në këtë rast, fshini pjesët e panevojshme.
- Për të luajtur përsëri të njëjtin program, shtypni ⊕ 14.

Shënim
- Kur disku xxirret ose kordoni i rrymës shkëputet pas programimit, të gjitha pjesët dhe skedarët e programuar do të fshihen.

Dëgjimi i radios

Sintonizimi te një stacion radioje

1 Shtypni FUNCTION 1 për të zgjedhur "FM" ose "DAB*" (CMT-X5CDB).
2 Mbani shtypur PRESET +/– 3 derisa treguesi i frekuencës në dritaren e ekranit 7 të fillojë të ndryshojë, më pas lëshojeni butonin.
Sintonizimi ndalon automatikisht kur kapet një transmetim stereo FM (**Skanim automatik**). "ST" ndizet në dritaren e ekranit 7.
* DAB është vetëm për CMT-X5CDB.

Sintonizimi manual

Shtypni PRESET +/– 3 në mënyrë të përsëritur për t'u sintonizuar në stacionin e dëshiruar.

Shënim mbi stacionet DAB/DAB+ (vetëm CMT-X5CDB)
- Kur sintonizoheni në një stacion që ofron shërbime RDS, transmetuesit japin informacione të tilla si emrin e shërbimit ose emrin e stacionit.
- Kur sintonizoheni në një stacion DAB/DAB+, mund të duhen disa sekonda para se të dëgjoni një zë.
- Shërbimi parësor merret automatikisht kur mbyllet shërbimi dytësor.
- Ky sintonizues nuk mbështet shërbimet e të dhënave.

Kësh illë
- Nëse marrja në një transmetim stereo FM është me zhurmë, shtypni MENU 19 dhe zgjidhni "TUNE:MENU", "FM MODE" dhe "MONO" njëra pas tjetrës, për të zgjedhur marrjen mono. Kjo redukton zhurmën.

Paravendosja e stacioneve të radios

Ju mund të paravendosni stacionet e preferuara të radios.

1 Sintonizohuni në stacionin e dëshiruar, më pas shtypni MENU 19.
2 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "TUNE:MENU", më pas shtypni ⊕ 14.
3 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "MEMORY", më pas shtypni ⊕ 14.
4 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "OK", më pas shtypni ⊕ 14.
5 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur numrin e paravendosjes që dëshironi, më pas shtypni ⊕ 14.

Numri i paravendosjes

Shfaqet "COMPLETE" në dritaren e ekranit 7 dhe stacioni radio regjistrohet me numrin e paravendosjes.
Përsëritni hapat e mësipërm për të regjistruar stacione të tjera radioje.
6 Shtypni I/⏻ 6 për të fikur rrymën, më pas shtypni I/⏻ 6 sërish për të ndezur rrymën.

Kësh illë
- Ju mund të paravendosni deri në 20 stacione FM ose 20 stacione DAB/DAB+ dhe 20 FM (CMT-X5CDB).
- Nëse zgjidhni një numër të paravendosur të regjistruar tashmë, stacioni i paravendosur i radios zëvendësohet me stacionin ku jeni sintonizuar aktualisht.

Për t'u sintonizuar te një stacion radioje i paravendosur

Shtypni PRESET +/– 3 për të zgjedhur numrin e paravendosur te i cili është regjistruar stacioni i dëshiruar.

Ekzekutimi i skanimit automatik DAB në mënyrë manuale (vetëm CMT-X5CDB)

Para se të mund të sintonizoheni në stacionet DAB/DAB+, duhet të kryeni një skanim fillestar të DAB.
Kur të keni lëvizur në një zonë tjetër, kryeni po ashtu skanimin fillestar të DAB për të përditësuar manualisht informacioninë e shërbimit DAB/DAB+.

1 Shtypni MENU 19.
2 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "TUNE:MENU", më pas shtypni ⊕ 14.
3 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "INIT:SCAN", më pas shtypni ⊕ 14.
4 Shtypni ♦/♦ 15 për të zgjedhur "OK", më pas shtypni ⊕ 14.
Fillon skanimi. Progresi i skanimit tregohet nga yjet (********). Në varësi të shërbimeve DAB/DAB+ të disponueshme në zonën tuaj, skanimi mund të zgjasë disa minuta.

Shënim
- Nëse vendi ose raj

Këshillë
- Telefonat e përputhshëm smartphone janë ata telefona që janë të pajisur me funksionin NFC (sistemi operativ i përputhshëm: Android versioni 2.3.3 ose version më i ri me përjashtim të Android 3.x).

Kontrolloni uebsajtin më poshtë për informacion mbi pajisjet e pajtueshme.
Për klientët në Evropë:
http://support.sony-europe.com/
Për klientët në vendet/rajonet e tjera:
http://www.sony-asia.com/support
- Për të shkëputur lidhjen e vendosur, prekni telefonin smartphone/tabletën me shenjën N [19] në njësi.
- Nëse telefoni smartphone/tableta nuk reagon megjithëse preket me njësinë, shkarkoni "NFC Easy Connect" në smartphone/tabletë dhe hapeni. Më pas prekeni me njësinë sërish. "NFC Easy Connect" është aplikacion falas për përdorim ekskluziv me Android™. Skanoni kodin 2D më poshtë.

- Kur prekni një telefon smartphone/tabletë të përputhshëm për NFC me njësinë ndërkohë që një pajisje tjetër BLUETOOTH është e lidhur me këtë sistem, pajisja BLUETOOTH shkëputet dhe sistemi lidhet me telefonin smartphone/tabletën.

Shënim
- Në disa vende dhe rajone, aplikacioni i përputhshëm me NFC mund të mos shkarkohet.
- Për disa telefona smartphone, ky funksion mund të jetë i disponueshëm pa e shkarkuar "NFC Easy Connect". Në një rast të tillë, përdorimi dhe specifikimet e telefonit smartphone/tabletës mund të jenë të ndryshme nga përshkrimi në këtë manual. Për detaje referojuni udhëzuesit të përdorimit që keni marrë me telefonin tuaj smartphone/tabletën.

Luajtja me kodek zanor me cilësi të lartë (AAC/aptX)

Ju mund të merrni të dhënat në formatin e kodekut AAC ose aptX nga një pajisje BLUETOOTH. Ajo ofron riprodhim me tingull me cilësi më të lartë.
Cilësimet e fabrikës të "BT AAC" dhe "BT APTX" janë "ON".

1 Shtypni MENU [19].
2 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "BT MENU", më pas zgjidhni ⊙ [14].
3 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "BT AAC" (kodeku AAC) ose "BT APTX" (kodeku aptX), më pas shtypni ⊙ [14].
4 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "ON", më pas shtypni ⊙ [14].

Shënim
- Nëse filloni konfigurimin gjatë lidhjes BLUETOOTH, lidhja do të ndërpritet.
- Nëse zëri ndërpritet gjatë marrjes në formatin e kodekut AAC, vendoseni në "OFF" në hapin 4 për të anuluar cilësimet. Në këtë rast, sistemi merr kodekun SBC.

Informacion shtesë

Vendosja e funksionit të gatishmërisë automatike

Sistemi kalon automatikisht në modalitetin e gatishmërisë pas 15 minutash kur nuk përdoret ose nuk ka dalje sinjali audio (**funksioni i gatishmërisë automatike**). Si parazgjedhje, funksioni i gatishmërisë automatike është i aktivizuar.

1 Shtypni MENU [19].
2 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "STBY: MODE", më pas shtypni ⊙ [14].
3 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "AUTO: STBY", më pas shtypni ⊙ [14].
4 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "ON" ose "OFF", më pas zgjidhni ⊙ [14].

Këshillë
- 2 minuta përpara se të hyni në modalitetin e gatishmërisë, shfaqet "AUTO: STBY" në dritaren e ekranit [7].

Shënim
- Funksioni i gatishmërisë automatike është i pavlefshëm për funksionin e sintonizuesit (FM/DAB*), edhe kur e keni aktivizuar
- Sistemi mund të mos kalojë automatikisht në modalitetin e gatishmërisë në rastet e mëposhtme:
  - ndërsa përdorni funksionin FM ose DAB*
  - ndërkohë që po diktohet një sinjal audio
  - gjatë riprodhimit të njesëve audio ose skedarëve
  - ndërkohë që po përdoret kohëmatësi i luajtjes ose kohëmatësi i fjetjes
- Sistemi numëron mbrapsht kohën (rreth 15 minuta) sërish derisa kalon në modalitetin e gatishmërisë, edhe kur funksioni i gatishmërisë automatike është aktivizuar në rastet e mëposhtme:
  - kur një pajisje USB lidhet ndërsa funksioni "USB"
  - kur është shtypur një buton në telekomandë ose njësi
- DAB është vetëm për CMT-X5CDB.

Vendosja e funksionit të gatishmërisë së BLUETOOTH

Kur aktivizohet modaliteti i gatishmërisë së BLUETOOTH, sistemi kalon në modalitetin e pritjes për lidhjen BLUETOOTH edhe kur sistemi është i fikur. Ky modalitet i gatishmërisë çaktivizohet si parazgjedhje.

1 Shtypni MENU [19].
2 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "STBY: MODE", më pas shtypni ⊙ [14].
3 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "BT STBY", më pas zgjidhni ⊙ [14].
4 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "ON" ose "OFF", më pas zgjidhni ⊙ [14].
5 Shtypni I/⏻ [6] për të fikur sistemin.

Këshillë
- Kur ky sistem është i çaktuar si "ON", sistemi aktivizohet automatikisht dhe mund të dëgjoni muzikë duke aktivizuar BLUETOOTH në komponentin e lidhur.

Aktivizimi/çaktivizimi i sinjalit me valë BLUETOOTH

Kur njësia ndizet, mund të kontrolloni një sinjal BLUETOOTH. Cilësimi i parazgjedhur është ON.

1 Ndizni pajisjen.
2 Mbani shtypur I⏮ [3] dhe I/⏻ [6] të njësisë.
3 Pas "RF OFF" (sinjali me valë BLUETOOTH është joaktiv) ose "RF ON" (shfaqet sinjali me valë BLUETOOTH, lëshoni butonin.

Këshillë
- Kur ky cilësim është vendosur në OFF, funksioni BLUETOOTH nuk është i disponueshëm.
- Edhe kur ky cilësim është çaktivizuar, njësia ndizet me telefonin smartphone/tabletë me veprimin me një prekje (NFC) në njësi.
- Kur ky cilësim është joaktiv, nuk mund të vendoset modaliteti i gatishmërisë së BLUETOOTH.
- Kur modaliteti i gatishmërisë së BLUETOOTH është aktiv dhe njësia është e fikur, modaliteti i gatishmërisë së BLUETOOTH çaktivizohet.
- Kur ky cilësim është joaktiv, njësia dhe pajisja BLUETOOTH nuk mund të çiftohen.
- Edhe kur ky cilësim është joaktiv, mund të përdoret gjithsesi një lidhje me tela.

Rregullimi i tingullit

Ju mund të vendosni përforcimin e basit dhe alton ose të rregulloni tonin sipas preferencave.

1 Shtypni SOUND [12].
2 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "CA+", "P-EQ" (efekti zanor), ose "WIDE ST" (efekti stereo), më pas shtypni ⊙ [14].

CA+: Vendoseni te cilësia e rekomanduar e zërit të Sony.
P-EQ (EQUALIZER): Zgjidhni tingullin e dëshiruar nga stilet e mëposhtme:
"R AND B/HIP HOP", "ROCK", "POPS", "CLASSIC", "JAZZ", "FLAT", "CUSTOM"
WIDE ST (WIDE STEREO): Zgjidhni "HIGH" ose "NORMAL", më pas shtypni ⊙ [14]. Nëse dëshironi ta përshtatni në një tingull stereo më natyral, zgjidhni "NORMAL".

Përdorimi i kohëmatësve

Sistemi ofron Kohëmatësin e fjetjes dhe Kohëmatësin e luajtjes.

Shënim
- Kohëmatësi i fjetjes ka prioritet ndaj kohëmatësit të luajtjes.

Caktimi i kohëmatësit të fjetjes

Në momentin e specifikuar, sistemi fiket automatikisht.

1 Shtypni MENU [19].
2 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "SLEEP", më pas shtypni ⊙ [14].
3 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur kohën e specifikuar, më pas shtypni ⊙ [14].
   Ju mund të zgjidhni nga "10MIN" (10 minuta) në "90MIN" (90 minuta) në shkallëzime prej 10 minutash.

Këshillë
- Për të kontrolluar kohën e mbetur të kohëmatësit të fjetjes, kryeni hapat 1 dhe 2 më lart.
- Kohëmatësi i fjetjes funksionon edhe nëse ora nuk është vendosur.

Për të anuluar kohëmatësin e fjetjes

Zgjidhni "OFF" në hapin 3 më lart.

Vendosja e Kohëmatësit të luajtjes.

Shënim
- Sigurohuni që të keni vendosur orën para se të vendosni kohëmatësin.
  Shihni "Vendosja e orës".

Kohëmatësi i luajtjes

Ju mund të dëgjoni një disk CD-DA ose MP3, pajisje USB ose radion çdo ditë në një orë të paravendosur.
Cilësimi i kohëmatësit të luajtjes mbetet për sa kohë që cilësimi nuk anulohet.

1 Përgatitni burimin e tingullit.
2 Shtypni TIMER [13].
3 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "PLAY SET", më pas shtypni ⊙ [14].
   Ora e nisjes pulson në dritaren e ekranit [7].
4 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur kohën, më pas shtypni ⊙ [14].
   Ndiqni të njëjtën procedurë për të vendosur "MINUTE" të kohës së fillimit të funksionimit, më pas "HOUR" dhe "MINUTE" të kohës së ndalimit të funksionimit.
5 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur burimin e dëshiruar të tingullit, më pas shtypni ⊙ [14].
   Shfaqet ekrani i konfirmimit për kohëmatësin e luajtjes.
6 Shtypni I/⏻ [6] për të fikur sistemin.

Këshillë
- Përpara kohës së paravendosur, sistemi ndizet automatikisht.
  - na FM ose DAB*: rreth 15 sekonda përpara kohës së paravendosur.
  - për një pajisje CD ose USB: rreth 90 sekonda përpara kohës së paravendosur.
- Kur burimi zanor është CD, mund të programoni paraprakisht kohëmatësin e luajtjes. Shikoni "Krijimi i programit individual (Luajtja e programit)".
- Kur burimi zanor është radio, sigurohuni që të sintonizoheni në stacionin paraprakisht.
- Për të ndryshuar cilësimin e kohëmatësit, kryeni sërish nga fillimi procedurat.
- DAB është vetëm për CMT-X5CDB.

Shënim
- Kohëmatësi i luajtjes nuk funksionon nëse sistemi është tashmë i ndezur në kohën e paravendosur. Kini kujdes që të mos e përdorni sistemin deri sa të ndizet dhe të fillojë luajtjen me kohëmatësin.
- Kur burimi i tingullit për një kohëmatës të luajtjes vendoset në një stacion radioje që e vendosni duke përdorur skanimin automatik (AUTO) ose skanimin manual (MANUAL) dhe ndryshoni frekuencën ose bandën e radios pasi vendosni kohëmatësin, edhe cilësimi i stacionit të radios për kohëmatësin do të ndryshojë gjithashtu.
- Kur burimi i tingullit për një kohëmatës të luajtjes vendoset në një stacion radioje të sintonizuar nga një stacion radioje i paravendosur, dhe ndryshoni frekuencën e stacionit të radios ose bandën pasi vendosni kohëmatësin, cilësimi i stacionit të radios për kohëmatësin nuk do të ndryshojë. Sintonizimi i stacionit të radios për kohëmatësin është i fiksuar në frekuencën që keni caktuar.

Për të kontrolluar cilësimin

1 Shtypni TIMER [13].
2 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "SELECT", më pas shtypni ⊙ [14].
3 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "TIMER SEL" dhe më pas shtypni ⊙ [14].
4 Shtypni ♦/♦ [15] për të zgjedhur "PLAY SEL" dhe më pas shtypni ⊙ [14].
   Cilësimi i kohëmatësit shfaqet në dritaren e ekranit [7].

Për të anuluar kohëmatësin

Pas hapit 3 në "Për të kontrolluar cilësimin", zgjidhni "OFF", më pas zgjidhni ⊙ [14].

Ndërrimi i baterisë

Distanca e funksionimit të telekomandës zvogëlohet me harxhimin e baterisë. Kur telekomanda nuk e vë në punë më njësinë, zëvendësoni baterinë me një bateri të re litiumi CR2025 (nuk jepet).

1 Mbani shtypur A në njesën e pasme të telekomandës, më pas nxirrni mbajtësen e baterisë në drejtim të shigjetës.



2 Zëvendësoni baterinë me "+" me pamje lart, më pas futni mbajtësen e baterisë në fole.

Mbajtësja e baterisë

Shënim
- Shtrojeni baterinë me një copë të thatë për të siguruar kontakt të mirë.
- Mos e mbani baterinë me piskatore metalike, ndryshe mund të shkaktohet qark i shkurtër.
- Përdorimi i baterive të tjera përveç CR2025 mund të shkaktojë zjarr ose shpërthim.

Rreth "SongPal"

Një aplikacion i dedikuar për këtë model është i disponueshëm si në Google Play™ dhe në App Store.

Cilësimet e tingullit

Ju mund të personalizoni me lehtësi tingullin, ose të përdorni cilësimet e rekomanduara të Sony "CA+".

Kontrollimi i një pajisjeje të lidhur me USB

Ju mund të luani muzikë në një pajisje të lidhur në konektorin USB.

Ajo që mund të kontrolloni me "SongPal" ndryshon në varësi të pajisjes së lidhur. Specifikimet dhe dizajni i aplikacionit mund të ndryshojnë pa dhënë njoftim.

Zgjedhja e pajisjes
Zgjidhni një pajisje të përputhshme "SongPal".

Cilësimet e pajisjes së lidhur
Shfaqen cilësime të ndryshme tingujsh. Kjo meny mund të shfaqet nga çdo ekran duke rrëshqitur djathtas.

Ekrani kryesor
Shfaq funksionet e pajisjes së zgjedhur dhe aplikacionet e instaluara në smartphone/iPhone.

Mini-luajtësi
Komanduesi për funksionin e zgjedhur.

Zgjidhja e problemeve

Zgjidhja e problemeve

1 Sigurohuni që kordoni i rrymës të jetë lidhur mirë.
2 Gjeni problemin që keni në listën e mëposhtme dhe ndërmerrni veprimin e lidhur korrigjues.
   Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me shitësin më të afërt Sony.

Nëse treguesi i gatishmërisë 5 pulson

Hiqni menjëherë nga priza kordonin e rrymës dhe sigurohuni që kordoni i rrymës të mos jetë i lidhur me një prizë muri ndryshe nga AC 220 V.
- Pasi treguesi i gatishmërisë 5 të ndalojë së pulsuari, rilidhni sërish kordonin elektrik dhe ndizni sistemin. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.

Të përgjithshme

Sistemi nuk ndizet.
- Sigurohuni që të keni lidhur kordonin e rrymës mirë me një prizë muri.

Sistemi ka kaluar papritur në modalitetin e gatishmërisë.
- Ky nuk është defekt. Sistemi kalon automatikisht në modalitetin e gatishmërisë pas 15 minutash kur nuk përdoret ose nuk ka dalje sinjali audio. Shikoni "Vendosja e funksionit të gatishmërisë automatike".

Cilësimi i orës ose funksionimi i kohëmatësit me luajtje është anuluar papritur.
- Nëse kalon rreth një minutë pa përdorim, cilësimi i orës ose cilësimi i kohëmatësit me luajtje anulohen automatikisht. Kryeni veprimin sërish nga fillimi.

Nuk ka tingull.
- Ngrini volumin në njësi.
- Sigurohuni që një komponent i jashtëm është i lidhur mirë me folenë AUDIO IN 3 dhe vendoseni funksionin në AUDIO IN.
- Stacioni i specifikuar mund të ketë ndaluar papritur transmetimin.

Ndodh gumëzhitje ose zhurmë e madhe.
- Lëvizeni sistemin larg burimeve të zhurmës.
- Lidhni sistemin në një prizë tjetër muri.
- Rekomandohet përdorimi i një burimi të energjisë së alternuar me një filtër zhurme (nuk është i përfshirë).

Telekomanda nuk funksionon.
- Hiqni çdo pengesë mes telekomandës dhe sensorit të telekomandës 11 në njësi dhe pozicionojeni njësinë larg dritave fluoreshente.
- Drejtojeni telekomandën drejt sensorit të telekomandës 11 në njësi.
- Lëvizeni telekomandën më pranë sistemit.
- Zëvendësoni baterinë.

Disk CD-DA/MP3

"LOCKED" shfaqet në dritaren e ekranit 7 dhe disku nuk mund të nxirret nga foleja e diskut 9.
- Këshillohuni me shitësin më të afërt Sony ose pikën lokale të autorizuar të shërbimit Sony.

Disku ose skedari nuk luhet.
- Disku që nuk është finalizuar (një disk CD-R ose CD-RW ku mund të shtohen të dhëna).

Tingulli kapërcehet ose disku nuk luhet.
- Disku mund të jetë i papastër ose i gërvishtur. Kur disku është i papastër, pastrojeni me fshirje.
- Zhvendoseni sistemin në një vend larg dridhjeve (për shembull, mbi një mbështetëse të qëndrueshme).

Luajtja nuk fillon nga pjesa e parë ose skedari i parë.
- Sigurohuni që të jetë i saktë modaliteti i aktual i luajtjes. Nëse modaliteti i luajtjes është "SHUFFLE" ose "PROGRAM", ndryshoni cilësimin.

Nisja e riprodhimit kërkon më shumë kohë se zakonisht.
- Disqet e mëposhtme mund të rrisin kohën që duhet për të nisur riprodhimin:
  - një disk i regjistruar me një strukturë të komplikuar peme.
  - një disk i regjistruar në formatin me shumë sesione.
  - një disk që ka shumë dosje.

Pajisja USB

Për detaje mbi pajisjet e pajtueshme USB, shihni "Pajisjet e përputhshme dhe versionet".

Është lidhur një disk ose pajisje USB e pambështetur.
- Mund të ndodhin problemet e mëposhtme.
  - Pajisja USB nuk njihet.
  - Emrat e skedarëve ose të dosjeve nuk shfaqen në këtë sistem.
  - Riprodhimi nuk është i mundur.
  - Tingulli kapërcehet.
  - Ka zhurmë.
  - Tingulli del i shtrembëruar.

Nuk ka tingull.
- Pajisja USB nuk është lidhur saktë. Fikni sistemin dhe më pas rilidhni pajisjen USB.

Ka zhurmë, tingulli kapërcehet ose është i shtrembëruar.
- Është lidhur një disk ose pajisje USB e pambështetur. Lidhni një pajisje USB që mbështetet.
- Fikni sistemin, pastaj rilidhni pajisjen USB dhe pas ndizni sistemin.
- Vetë të dhënat muzikore përmbajnë zhurmë, ose tingulli është i distortuar. Zhurma mund të jetë futur gjatë krijimit të të dhënave muzikore për shkak të gjendjes së kompjuterit. Në një rast të tillë, fshini skedarin dhe dërgoni përsëri të dhënat e muzikës.
- Shpejtësia në bit e përdorur gjatë kodimit të skedarëve shite e ulët. Dërgoni te pajisja USB skedarët e koduar me shpejtësi në bit më të larta.

"READING" shfaqet për një periudhë të gjatë kohe, ose duhet shumë përpara se të fillojë riprodhimi.
- Procesi i leximit mund të kërkojë një kohë të gjatë në rastet e mëposhtme.
  - Kur ka shumë dosje ose skedarë në pajisjen USB.
  - Kur struktura e skedarëve është jashtëzakonisht e ndërlikuar.
  - Nuk ka hapësirë të lirë të mjaftueshme në memorie.
  - Kur memoria e brendshme është e fragmentuar.

Emri i skedarit ose dosjes (emri i albumit) nuk shfaqet saktë.
- Dërgoni përsëri te pajisja USB të dhënat muzikore, pasi të dhënat e ruajtura në pajisjen USB mund të jenë të dëmtuara.
- Kodet e karaktereve që mund të shfaqen nga ky sistem janë si më poshtë:
  - Shkronjat e mëdha (A deri në Z).
  - Numrat (0 deri në 9).
  - Simbolet (< > * +, [ ] @ \ _).

  Karakteret e tjera shfaqen si "_".

Pajisja USB nuk njihet.
- Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizni sistemin.
- Mund të jetë lidhur një pajisje e papajtueshme USB.
- Pajisja USB nuk punon siç duhet. Referojuni manualit të përdorimit që shoqëron pajisjen USB mbi mënyrën e trajtimit të këtij problemi.

Luajtja nuk fillon.
- Fikni sistemin dhe rilidhni pajisjen USB, më pas ndizni sistemin.
- Mund të jetë lidhur një pajisje e papajtueshme USB.

Luajtja nuk fillon nga pjesa e parë.
- Vendosni modalitetin e luajtjes në modalitetin "NORMAL" të luajtjes..

Pajisja USB nuk mund të ngarkohet.
- Sigurohuni që pajisja USB të jetë lidhur mirë me portën (USB) A.
- Pajisja USB mund të mos mbështetet nga ky sistem.
- Shkëputni pajisjen USB dhe më pas rilidheni atë. Për detaje, mbi statusin e karikimit të pajisjes USB, shihni manualin e përdorimit të pajisjes USB.

Sintonizuesi

Ndodh gumëzhitje ose zhurmë e madhe ("STEREO" pulson në dritaren e ekranit 7) ose transmetimet nuk mund të merren.
- Lidheni antenën mirë.
- Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali dhe më pas vendosni antenën sërish.
- Mbajeni antenat larg nga njësia, kordoni i altoparlantit ose komponentët e tjerë për të shmangur kapjen e zhurmës.
- Fikni pajisjet elektrike aty pranë.

Dëgjohen disa stacione radioje në të njëjtën kohë.
- Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali dhe më pas vendosni antenën sërish.
- Bashkoni kabllot e antenave duke përdorur kapëse kordonësh që qarkullojnë në treg dhe rregulloni gjatësitë e kabllove.

Stacioni i radios DAB/DAB+ nuk merret si duhet.
- Kontrolloni të gjitha lidhjet e antenave, më pas procedurën e skanimit automatik DAB. Shihni "Ekzekutimi i skanimit automatik DAB në mënyrë manuale (vetëm CMT-X5CDB)".
- Shërbimi aktual DAB/DAB+ mund të mos jetë i disponueshëm. Shtypni TUNING +/– 3 për të zgjedhur një shërbim tjetër.
- Nëse keni lëvizur në një zonë tjetër, disa shërbime/frekuenca mund të kenë ndryshuar dhe mund të mos arrini të sintonizoheni në transmetimin tuaj të zakonshëm. Kryeni procedurën e skanimit automatik DAB për të regjistruar përsëri përmbajtjet e transmetimeve. (Kryerja e kësaj procedure pastron të gjitha paravendosjet e ruajtura më parë.)

Transmetimi DAB/DAB+ është ndërpreër.
- Kontrolloni vendndodhjen e sistemit ose rregulloni orientimin e antenës për të rritur vlerën e treguar të cilësisë së sinjalit.

Për të rivendosur sistemin në cilësimet e fabrikës

Nëse sistemi vazhdon të mos funksionojë mirë, rivendosni sistemin në cilësimet e fabrikës. Përdorni butonat në njësi për të rivendosur sistemin në cilësimet e fabrikës.

1 Shkëputni kordonin elektrik dhe konfirmoni që treguesi i gatishmërisë 5 nuk është i ndriçuar. Më pas lidhni përsëri kordonin elektrik dhe ndizni sistemin.
2 Mbani shtypur FUNCTION 1 dhe I/⏻ 6 në njësi derisa të shfaqet "RESET" në ekran.
   Fshihen të gjitha cilësimet e konfiguruara nga përdoruesi, siç janë stacionet e paravendosura të radios, kohëmatësi dhe ora.
   Nëse problemi vazhdon pasi të kryeni të gjitha sa më sipër, këshillohuni me shitësin më të afërt të Sony.

Shënim
- Nëse e hidhni apo ia jepni njësinë një personi tjetër, për siguriné tuaj kryeni një rivendosje të njësisë.

Mesazhet

Mesazhet e mëposhtme mund të shfaqen ose të pulsojnë gjatë funksionimit.

CANNOT PLAY: Sistemi nuk mund të luajë skedarët audio për shkak të një formati skedari të pambështetur ose një kufizimi të luajtjes.
CAN'T PLAY: Keni caktuar një disk që nuk mund të riprodhohet në këtë sistem, si disk CD-ROM dhe DVD.
COMPLETE: Funksioni i paravendosur i stacionit përfundoi normalisht.
DATA ERROR: Keni provuar të luani një skedar që nuk mund të luhet.
ERROR: Keni përdorur sistemin gjatë procesit të fillimit. Prisni pak deri sa të përfundojë procesi i fillimit.
FULL: Keni provuar të programoni më shumë se 25 pjesë ose skedarë.
LOCKED: Foleja e diskut 9 është e bllokuar dhe nuk mund ta hiqni diskun. Kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.
NO DEVICE: Nuk është lidhur asnjë pajisje USB ose pajisja e lidhur USB është shkëputur.
NO DISC: Nuk ka disk në luajtës, ose keni ngarkuar një disk që nuk mund të luhet.
NO MEMORY: Mjeti i memories nuk është futur në pajisjen USB ose sistemi nuk e identifikon mjetin e memories.
NO STEP: Janë fshirë të gjitha pjesët e programuara.
NO SUPPORT: Sistemi nuk e mbështet pajisjen USB të lidhur.
NO TRACK: Në pajisjen USB ose në disk nuk ka skedarë që mund të luhen.
NOT IN USE: Keni shtypur një buton që nuk luhet.
OVER CURRENT: Shkëputni pajisjen USB nga porta, fikni sistemin dhe më pas ndizni përsëri sistemin.
PUSH STOP: Jeni përpjekur të ndryshoni modalitetin e luajtjes gjatë riprodhimit në funksionin CD ose USB.
READING: Sistemi po lexon informacionet në CD ose në pajisjen USB. Disa butona nuk punojnë gjatë leximit.
TIME NG: Kohë e fillimit dhe përfundimit të kohëmatësit me luajtje janë vendosur në të njëjtën kohë.

Masat paraprake/ Specifikimet

Masat paraprake

Disqet që MUND të luhen në këtë sistem
- Disqet CD-DA audio
- CD-R/CD-RW (të dhëna audio të njesëve të CD-DA dhe skedarë MP3)

Mos përdorni një disk CD-R/CD-RW pa të dhëna të ruajtura në të. Duke vepruar kështu mund të dëmtoni diskun.

Disqet që NUK MUND të luhen në këtë sistem
- CD-ROM
- CD-R/CD-RW përveç atyre të regjistruara në format CD muzikore ose format MP3 që janë në përputhje me ISO9660 Niveli 1/Niveli 2, Joliet
- CD-R/CD-RW të regjistruara në format me shumë sesione dhe që nuk kanë mbyllur sesionin
- CD-R/CD-RW me cilësi të dobët regjistrimi, CD-R/CD-RW që kanë gërvishtje ose janë të ndotura, ose CD-R/CD-RW të regjistruara me një pajisje regjistrimi të papajtueshme
- CD-R/CD-RW që nuk janë finalizuar saktë
- Disqet CD-R/CD-RW që përmbajnë skedarë përveç skedarëve MPEG 1 Audio Layer-3 (MP3)
- Disqet 8 cm
- Disqet me forma jostandarde (p.sh. në formë zemre, katrore, ylli)
- Disqet që kanë shirit adeziv, letër ose material ngjitës përsipër
- Disqet me qira ose të përdorura me vula të ngjitura ku ngjitësja kalon përtej vulës
- Disqet që kanë etiketa të printuara me bojë që kur preket duket ngjitëse

Shënime mbi disqet CD-DA
- Përpara luajtjes, fshini diskun me një pëlhurë pastrimi duke fërkuar nga qendra drejt anëve.
- Mos i pastroni disqet me tretës si benzina, holluesit ose pastruesit që qarkullojnë në treg, ose sprejët antistatikë që përdoren për disqet LP prej vinili.
- Mos i ekspozoni disqet ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose burimeve të nxehtësisë siç janë tubacionet e ajrit të nxehtë, ose mos e lini në një makinë të parkuar në dritë të drejtpërdrejtë dielli.

Për sigurinë
- Shkëputni plotësisht kordonin e rrymës (rrjetit elektrik) nga priza e murit (rryma) nëse nuk do të përdorët për një periudhë të gjatë kohe. Kur hiqni sistemin nga priza, gjithmonë mbajeni me dorë prizën. Asnjëherë mos tërhiqni vetë kordonin.
- Nëse brenda në sistem bie diçka e fortë ose lëng, sistemi duhet të hiqet nga priza dhe duhet të kontrollohet nga një personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.
- Kordoni i rrymës alternative mund të zëvendësohet vetëm nga një dyqan servisi i kualifikuar.

Për vendosjen
- Mos e vendosni sistemin në një pozicion të pjerrët ose në vende që janë shumë të nxehta, të ftohta, me pluhur, të ndotura ose me lagështirë ose ku mungon ajrosja e mjaftueshme apo ku mund t'u nënshtrohet dridhjeve, dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose dritës së fortë.
- Kini kujdes kur vendosni sistemin mbi dysheme me trajtim të veçantë (për shembull të trajtuara me dyllë, vaj, me lustër) duke qenë se mund të rezultojë në njolla ose çnjysrosje.
- Nëse sistemi sillet direkt nga një vend i ftohtë në një vend të ngrohtë, ose vendoset në një dhomë shumë të lagështë, lagështira mund të kondensohet mbi lentet brenda luajtësit të CD-ve dhe të bëjë që sistemi të keqfunksionojë. Në këtë situatë, hiqni diskun dhe lëreni sistemin të ndezur për rreth një orë derisa të avullojë lagështira. Nëse sistemi vazhdon të mos funksionojë, edhe pas një periudhë të gjatë kohe, konsultohuni me shitësin më të afërt Sony.

Për akumulimin e nxehtësisë
- Akumulimi i nxehtësisë në njësi gjatë karikimit ose funksionimit për një kohë të gjatë është normal dhe nuk është shkak për t'u alarmuar.
- Mos e prekni kasën e pajisjes nëse është përdorur në mënyrë të vazhdueshme me volum të lartë sepse kasa e pajisjes mund të jetë nxehur.
- Mos bllokoni vrimat e ajrimit.

Pastrimi i kasës së pajisjes
Pastrojeni këtë sistem me një pëlhurë të butë, disi të njomur me solucion të butë larës. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si holluesit, alkooli ose benzina.

Pajisjet e përputhshme dhe versionet

iPhone/iPad/iPod touch

Kontrolloni uebsajtet e mëposhtme për detaje mbi versionet e mbështetura të pajisjeve të pajtueshme:
Për klientët në Evropë:
http://support.sony-europe.com/
Për klientët në vende/rajone të tjera:
http://www.sony-asia.com/support

Modelet e përputhshme	Bluetooth®
iPhone 5s	○
iPhone 5c	○
iPhone 5	○
iPhone 4s	○
iPhone 4	○
iPhone 3GS	○
iPad Air*	○
iPad mini me ekran Retina*	○
iPad (4th generation)*	○
iPad mini*	○
iPad (3rd generation)*	○
iPad 2*	○
iPad*	○
iPod touch (5th generation)	○
iPod touch (4th generation)	○
iPod touch (3rd generation)*	○
iPod nano (7th generation)*	○

* "SongPal" nuk mbështet iPod touch (3rd generation), iPod classic dhe iPod nano.
"SongPal" nuk mbështet iPad që prej 1 janarit 2014.

Teknologjia Bluetooth funksionon me iPhone 5s, iPhone 5c, iPhone 5, iPhone 4s, iPhone 4, iPhone 3GS, iPod touch (5th generation), iPod touch (4th generation).

Pajisja USB

Kontrolloni uebsajtet e mëposhtme për detaje mbi versionet e mbështetura të pajisjeve të pajtueshme:
Për klientët në Evropë:
http://support.sony-europe.com/
Për klientët në vende/rajone të tjera:
http://www.sony-asia.com/support

Teknologjia BLUETOOTH me valë

Teknologjia BLUETOOTH me valë është një teknologji me rreze të shkurtër për lidhjen e pajisjeve dixhitale, si kompjuterë personalë dhe kamera fotografike dixhitale. Me anë të teknologjisë Bluetooth me valë, ju mund të përdorni njësitë e përfshira brenda një rrezeje rreth 10 metra.
Teknologjia BLUETOOTH me valë zakonisht përdoret mes dy pajisjeve, por një pajisje e vetme mund të lidhet edhe me pajisje të shumta.
Nuk nevojiten lidhje kabllore për t'u lidhur si me një lidhje USB, dhe nuk nevojitet vendosja e pajisjeve ballë për ballë si me teknologjinë infra të kuqe me valë. Mund të përdorni teknologjinë me një pajisje BLUETOOTH në çantë apo në xhep.
Teknologjia Bluetooth me valë është një standard global që mbështetet nga mijëra kompani. Këto kompani prodhojnë produkte që përputhen me standardin global.

Versioni dhe profilet e mbështetura BLUETOOTH

Profili i referohet një seti standard kapacitetesh për kapacitete të ndryshme të produkteve BLUETOOTH. Shikoni "Specifikimet" për hollësi mbi versionin dhe profilet e mbështetura BLUETOOTH.

Shënim
- Për të përdorur një pajisje BLUETOOTH të lidhur me këtë sistem, pajisja duhet të mbështetë të njëjtin profil si ky sistem. Kini parasysh se funksionet e pajisjes BLUETOOTH mund të jenë të ndryshme në varësi të specifikimeve të pajisjes, edhe nëse ka të njëjtin profil si ky sistem.
- Për shkak të vetive të teknologjisë BLUETOOTH me valë, luajtja në këtë sistem është pak e vonuar në krahasim me luajtjen audio në pajisjen transmetuese.

Rreza efikase e komunikimit

Pajisjet BLUETOOTH duhet të përdoren brenda afërsisht 10 metrave (distancë pa pengesa) nga njëra-tjetra. Rreza efikase e komunikimit mund të shkurtohet në kushtet e mëposhtme.
- Kur mes pajisjeve me lidhje BLUETOOTH ndodhet një person, objekt metalik, mur apo pengesë tjetër
- Vendndodhjet ku është instaluar një LAN me valë
- Rreth furrave me mikrovalë që janë në përdorim
- Vendndodhjet ku ka valë të tjera elektromagnetike

Efektet e pajisjeve të tjera

Pajisjet BLUETOOTH dhe rrjeti LAN me valë (IEEE 802.11b/g) përdorin të njëjtin brez frekuence (2,4 GHz). Kur përdorni pajisjen tuaj BLUETOOTH pranë një pajisjeje me kapacitet për LAN me valë, mund të ndodhin interferenca elektromagnetike. Kjo mund të sjellë shpejtësi më të ulëta të transferimit të të dhënave, zhurmë ose pamundësi për t'u lidhur. Nëse ndodh kjo, provoni zgjidhjet e mëposhtme:
- Provoni ta lidhni këtë sistem dhe telefonin celular BLUETOOTH ose pajisjen BLUETOOTH kur jeni të paktën 10 metra larg nga pajisja LAN me valë.
- Fikni rrymën e pajisjes LAN me valë kur përdorni pajisjen tuaj BLUETOOTH brenda 10 metrave.

Efektet në pajisjet e tjera

Valët radio të transmetuara nga ky sistem mund të interferojnë në funksionimin e pajisjeve mjekësore. Duke qenë se kjo interferencë mund të sjellë keqfunksionim, fikni gjithmonë rrymën e këtij sistemi, telefonin celular BLUETOOTH dhe pajisjen BLUETOOTH në vendet e mëposhtme:
- Nëpër spitale, trena dhe avionë
- Pranë dyerve automatike ose alarmeve të zjarrit

Shënim
- Ky